



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.11.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj –kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” për Ministrinë e Brendshme.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Anduel Xhindi, Klodjana Spahiu dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Paulin Sterkaj, Elona Hoxha, Myslim Murrizi, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Braimllari, Xhemal Gjunkshi dhe Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Julian Hodaj - Zëvendësministër i Brendshëm

Dritan Palnikaj - Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme

Viktor Hysa - Shef finance në Ministrinë e Brendshme

Fran Brahimi - Drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj– Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës së këtij komisioni kemi shqyrtimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”, konkretisht për buxhetin që do t’i akordohet Ministrisë së Brendshme.

Të ftuar për të prezantuar projektbuxhetin nga Ministria e Brendshme kemi zëvendësministrin e Brendshëm, zotin Julian Hodaj; sekretarin e Përgjithshëm, zotin Dritan Palnikaj; shefin e Financës, zotin Viktor Hysa, si dhe drejtorin e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, zotin Fran Brahimi. Relator i këtij projektligji është zoti Pjerin Ndreu.

Fjala është për ju, zoti zëvendësministër, për të bërë prezantimin e projektbuxhetit. Më pas fjalën e ka relatori Pjerin Ndreu.

Julian Hodaj – Faleminderit!

Mirdita, zonja zëvendëskryetare dhe deputetë!

Ministria e Brendshme në projektligjin e buxhetit të vitit 2019 ka 5 programe buxhetore: për Policinë e Shtetit, për Gardën e Republikës, për planifikim menaxhim dhe administrim, për prefekturën dhe funksionet e deleguara, si dhe për gjendjen civile.

Numri i punonjësve të propozuar për këtë ministri, të parashikuar në projektligjin e buxhetit për vitin e ardhshëm është 14 mijë e 149 punonjës, të ndarë në strukturat e sipërpërmendura, ku pjesën më të madhe e ka Policia e Shtetit me 10 mijë 958 punonjës, më pas vjen Garda e Republikës e të tjerë me radhë. Buxheti i propozuar për vitin 2019 është me rreth 1% rritje krahasuar me buxhetin e vitit 2018. Për sa i përket buxhetit të Policisë së Shtetit është pak a shumë në ato nivele që ishte edhe në vitin 2018, me 16 miliardë lekë. Kuptohet që zërat e buxhetit janë: shpenzime personeli, shpenzime për investime ose me bashkëfinancim dhe shpenzime të tjera. Buxheti i parashikuar për planifikim, menaxhim dhe administrim ka një rritje me rreth 11,5%, që reflektohet në të gjithë këta zëra.

Lidhur me buxhetin e Gardës së Republikës, jemi pak a shumë në të njëjtat nivele me vitin 2018, me një rritje të mirë për shpenzimet e personelit me rreth 7,9%, krahasuar me një vit më parë. Kemi një rritje rreth 10% për sa u përket prefekturave, ku buxheti i parashikuar për vitin 2019 është rreth 606 milionë lekë, ndërsa gjendja civile në dukje duket sikur i ulët buxheti me 11% , por kjo vjen si pasojë e vendimit për kalimin e mirëmbajtjes së gjendjes civile tek AKSHI. Kështu

që automatikisht ulja e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile reflektohet në rritjen e buxhetit që i bëhet AKSHI-t për të njëjtat qëllime.

Nëse përmendim disa projekte kryesore, të cilat janë parashikuar në buxhetin e vitit 2019, vlen të veçohen ndërtimi i bllokut të sigurisë dhe rikonstruksioni i dhomave të shoqërimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Ky është një investim i konsiderueshëm me parametra optimalë dhe europianë për sa i përket trajtimit të personave që shoqërohen. Gjithashtu, është parashikuar rikonstruksioni i godinës së repartit RENE A; ndërtimi i godinës së Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, si dhe një investim i konsiderueshëm për sa u përket pajisjeve të teknologjike dhe informacionit, ku mund të veçohen: investimi që do të kryhet për teknologjinë e komunikimit LTE, ndërtimi i *data center* –it, si dhe salla e serverëve në Policinë e Shtetit. Gjithashtu, duhet të përmenden edhe blerjet e automjeteve për qëllime operacionale për Policinë e Shtetit, me një shifër të konsiderueshme rreth 179 milionë lekë. Kaq kisha në terma të përgjithshëm.

Për çdo pyetje të gjithë jemi të gatshëm t'ju përgjigjemi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Hodaj!

Fjala është për relatorin për të na bërë një prezantim të përgjithshëm të projektbuxhetit të vitit 2019.

Pjerin Ndreu – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Për të mos rënë në përsëritje të asaj çka tha zëvendësministri, duhet të evidentoj vëmendjen e shtuar vit pas viti të qeverisë në drejtim të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Faktet tregojnë se për vitin 2018 ne kemi dhënë një fond 4,8% më shumë se viti 2017, për të mos përmendur vitin 2013, kur ne erdhëm në pushtet, që tregon se qeveria i ka kushtuar një vëmendje shumë të veçantë mbarrëvajtjes së punës në të gjitha drejtoritë, që mbulon Ministria e Punëve të Brendshme, duke e konsideruar si një prioritet ku ne duhet të ndërhyjmë për shkak të asaj situatë, që nuk është rasti ta risjellim në vëmendje.

Gjithsesi, edhe në vitin 2019, duke përjashtuar atë që ka lidhje me AKSHI-n, të cilin ju e përmendët shumë mirë, ne do të mbajmë të njëjtin temp dhe do të vazhdojmë të mbështesin Ministrinë e Brendshme me fonde. Ne, si Komisioni i Sigurisë, përveç mbështetjes që do t'i japim buxhetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe projeksionit që ka bërë Ministria e Financave me qeverinë, na duhet të tërheqim vëmendjen edhe për disa problematika, të cilat i kemi hasur dhe duhet të gjejmë zgjidhje me buxhetin e vitit 2019. Ka mungesë të logjistikës dhe gjendja e mjeteve

dhe pajisjeve në institucionet e Policisë Kufitare dhe Emigracionit është e vështirë. Kjo është konstatuar gjatë vizitave tona në terren. Gjithashtu, ka mungesë të burimeve njerëzore, sidomos në pikat e kalimit kufitar, problem që duhet të ezaurohet; ka mungesë të theksuar të infrastrukturës së godinave të pikave të kalimit kufitar; ka armatime të vjetruara dhe panjësuar, si dhe duhet bërë një unifikim i pagave për oficerët e shërbimit. Pra, fluksi i investimeve urgjente duhet të shkojë realisht aty ku ka nevojë. Ne mund të përmirësojmë edhe punën në drejtim të krimit të organizuar, sepse, në fund të fundit, trafiqet realizohen në kufi. Pra, trafiqet kanë natyrë ndërkombëtare dhe nëse ne do të forcojmë shërbimet në kufi kjo do të thotë se kemi marrë masat e duhura për luftën kundër trafikeve. Unë jam i bindur se kapacitetet profesionale dhe politike të Ministrisë së Punëve të Brendshme janë të atij lloji që e mirëmenaxhojnë buxhetin. Unë mendoj se do të ketë një detajim, pas miratimit të këtij buxheti, më të përqendruar pikërisht në pikat që ne thamë, sepse është absolutisht emergjente.

Duke ju falënderuar për shpjegimet që ju bëtë dhe për bashkëpunimin, që kemi pasur në proces gjatë gjithë vitit, unë ju bëj thirrje kolegeve që ta mbështesim dhe ta miratojnë buxhetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Ndreu!

Besoj se për kolegët është e qartë se buxheti, që i akordohet Ministrisë së Brendshme këtë vit, është pothuajse njësoj me buxhetin e kaluar.

Në fakt, kjo gjë është e njohur për kolegët, por dua të theksoj për mediet dhe publikun, që buxheti i akorduar Ministrisë së Punëve të Brendshme vijon të jetë një ndër buxhet më të mëdha në raport me çdo institucion tjetër qendror, por në raport edhe me 11 vjetët e fundit.

Normalisht në ligjin “Për buxhetin e vitit 2019” do të shikoni se parashikohet që të rriten standardet e punës në një sërë njësisish, që varen nga institucioni i Ministrisë së Brendshme. Në këtë buxhet kërkohet të bëhet informatizimi i të gjithë zyrave të shërbimit të qytetarëve; pajisja me mjete speciale për Policinë Rrugore, në mënyrë që efekti parandalues i punës së kësaj njësie të vijojë të jetë edhe më i ndjeshëm; parashikohet të bëhen ndërhyrje në disa pika të kalimit kufitar, jo vetëm në pikën e klimat kufitar të Hanit të Hotit, por edhe në pikat e kalimit kufitar Qafë Botë dhe Kapshticë.

Në fakt, neve na vjen mirë që projektbuxheti i ka paraprirë kësaj gjëje, sepse Komisioni i Sigurisë, sipas kalendarit të vizitave që ka organizuar në disa pika të kalimit kufitar (deri tani ne kemi pasur rast të vizitojmë të gjitha pikat më të mëdha të kalimit kufitar në vend), ka parë se k

nevojë të ndërhyhet në infrastrukturë, por edhe në logjistikë, ashtu sikurse edhe relatori e vuri në dukje. Arsyeja është e thjeshtë: ne duhet që ta prioritojmë buxhetin në kuptimin që t'u vijmë në ndihmë nevojave më emergjente, në mënyrë që t'i bëjmë më të ndjeshme rezultatet e punës së Policisë së Shtetit në përgjithësi. Pra, ndërhyrja në këtë rast ishte për këtë pjesë, të cilën jo vetëm kemi pasur rastin ta konstatojmë, por edhe ta bisedojmë me punonjës të nivelit zbatues.

Gjithsesi, pa dashur të zgjatem, dua t'ia kaloj fjalën kolegëve për pyetje lidhur me buxhetin dhe nevoja të tjera që mund të kemi, sepse, siç e thashë, këtu kemi edhe përfaqësues nga Ministria e Financave. Në qoftë se Ministria e Brendshme ka diçka, që nuk është e reflektuar në shumën e përgjithshme të të hollave që synojnë që t'i akordohet kësaj ministrie, do të ishte rasti më i mirë për ta biseduar dhe për ta mbështetur në komisionin tonë.

Parimisht ky komision ka qenë gjithmonë në mbështetje të nevojave financiare të institucioneve të sigurisë, sepse kuptohet kur flasim për institucionet e sigurisë nuk ka rëndësi thjesht dhe vetëm vullneti apo dëshira për të punuar mirë e këtyre punonjësve, por ka rëndësi të jashtëzakonshme edhe mbështetja që ne u japim atyre vit pas viti, si dhe vëmendja që kjo mbështetje të jetë e duhura dhe të shkojë në ato sektorë ku nevoja është më e madhe.

Fjala është për ju kolegë.

Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia- Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, edhe nga relatimi që bëri kolegu Ndreu, por edhe ju e përmendët, ka një hov cilësor për sa i përket realizimit të buxhetit për vitin 2018. Për këtë duhet përgëzuar i gjithë stafi i Ministrisë së Brendshme, i cili ka bërë të mundur që ky buxhet të shkojë në drejtimin e duhur. Gjithsesi, unë kam dy pyetje.

Së pari, në vitin 2018 u bë kalimi i emergjencave civile nga dikasteri i huaj te Ministria e Mbrojtjes. A është bërë kalimi i të gjitha aseteve dhe mjeteve të tjera, të cilat i ka pasur në dispozicion emergjencia apo vazhdojnë të jenë ende pjesë e ministrisë suaj?

Së dyti, anëtarët e Komisionit të Sigurisë, në sajë edhe të këmbënguljes së kryetares, kanë bërë të mundur të asistojmë në disa nga institucionet që janë në juridiksionin tuaj. Ajo çfarë vazhdon të mbetet shqetësuese, ndoshta është momenti që ta ribëjmë edhe njëherë prezent, janë pagat e ulëta të punonjësve të institucioneve në varësi të ministrisë suaj, kryesisht të Gardës së Republikës. A keni menduar ju, në cilësinë e zëvendësministrit (ndoshta kjo gjë nuk është pjesë e buxhetit), apo dikasteri juaj për të përgatitur draftet ose projektligjin e duhur, që edhe punonjësit

e Gardës së Republikës të trajtohen njëloj me pagë si punonjësit e Policisë së Shtetit? Punonjësit e Gardës së Republikës vërtet trajtohen me paga, të cilat janë pothuajse qesharake.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Qefalia!

Fjala është për zotin Palnikaj.

Dritan Palnikaj – Faleminderit!

Ndoqa me vëmendje relatimin e zotit Ndreu dhe të zotit Qefalia.

Në lidhje me problematikat e ngritura nga relatori për sa u përket çështjeve kufitare, automjeteve dhe armatimit, sigurisht që këto problematika qëndrojnë dhe ne jemi në fazë përmirësimi brenda mundësive dhe limiteve që na jep buxheti. Ministria e Brendshme në lidhje me unifikimin e pagesave për vitin 2019 ka parashikuar një plan dhe ka tashmë një projektligj, që besoj se në të ardhmen do t'i vihet në dispozicion Kuvendit, por edhe Komisionit të Sigurisë. Tendenca do të jetë për unifikimin e gradave, por edhe të pagesave për 3 institucionet, që ka në varësi Ministria e Brendshme, që janë: SHÇBA-ja, Garda e Republikës dhe Policia e Shtetit. Kjo patjetër që do të dakordësohet edhe me Komisionin e Sigurisë.

Në lidhje me kalimin e aseteve për emergjencat civile, vlen të theksohet se në datën 1 janar të vitit 2018 emergjenca civile ka kaluar zyrtarisht në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, ku ka një urdhër të përbashkët midis dy ministrave që është bërë kalimi i kapitalit dhe i çdolloj gjëje dhe çdo aset nga Ministria e Brendshme te Ministria e Mbrojtjes. Domethënë ky është një proces i ezauruar dhe ata tashmë kanë vijuar punën për përballimin e situatave.

Ermonela Felaj – Po, zoti Duzha.

Luan Duzha- Faleminderit, zonja kryetare!

A ka dieta apo pagesa të prapambetura për punonjësit e policisë, pasi, siç e dimë, ata punojnë me orar të zgjatur? Nëse ka pagesa të prapambetura, a janë parashikuar ato për t'u shlyer në këtë buxhet?

Dëgjova se rreth 170 milionë lekë janë parashikuar për blerjen e automjeteve. Dihet se komisariatet janë shumë keq për sa u përket automjeteve dhe po marr shembull komisariatit e Cërrikut, i cili ka vetëm një makinë në gjendje pune. A ka ndonjë fond të parashikuar në këtë buxhet për riparimin e automjeteve, që janë në gjendje pune, sepse një komisariat me një makinë nuk ka çfarë të bëjë?

Ermonela Felaj – Po, zoti Hysa.

Viktor Hysa – Faleminderit!

Për sa u përket pyetjeve që kanë të bëjnë me çështjen për mbulimin e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta, mund të them se vitin buxhetor 2018-2019 parashikojmë ta mbyllim pa asnjë lloj detyrimi të mbartur për sa u përket këtyre shpenzimeve. Njëkohësisht, në buxhetin e vitit 2019 janë parashikuar fonde të nevojshme për këto shpenzime dhe për mbikohën e punës për shkak të ngarkesës suplementare që do të kenë strukturat e Policisë së Shtetit për garantimin e procesit zgjedhor.

Për sa i përket çështjes së blerjes së automjeteve, ne kemi një projekt në bashkëfinancim të huaj, ku vlera do të jetë e konsiderueshme për blerjen e këtyre mjeteve, ndërsa fondi i riparimit dhe i mirëmbajtjes së automjeteve është parashikuar në planin e buxhetit të Policisë së Shtetit dhe është financuar në ato nevoja që është parashikuar nga ky program. Kuptohet, edhe në raport me ngarkesat, gjatë vitit mund të rishikohet buxheti, mund të bëhen rialokime nëpërmjet programeve, në mënyrë që këto shërbime të jenë të mbuluara totalisht dhe të mos kemi probleme. Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Hysa!

Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Në radhë të parë, dua t’ju falënderoj për punën e mirë që po bëni, si dhe për kujdesin e treguar në publik, lidhur me problemet e fundit që kishin të bënin me largimin e ministrit! Kjo tregon punën e mirë që ju po bëni. Shpresoj që buxheti i vitit që vjen të jetë një buxhet që t’u plotësojë të gjitha kërkesat!

Unë, në fakt, do të flas për zonën time, që është Bashkia e Selenicës dhe kam të njëjtin problem si kolegu. Atje është vetëm një stacion policie dhe nuk ka komisariat. Ajo bashki është shumë e madhe dhe ka 6 njësi administrative, si: Sebaste, Smokthinë, ku zona shtrihet deri afër Kuçit dhe ka një territor malor shumë të vështirë. Pra, në këtë zonë nuk mund të plotësohen dot nevojat me një mjet të vetëm policie.

Unë propozoj që stacionin e policisë së Selenicës ta ktheni në komisariat policie, sepse është e pamundur në atë terren malor të kërkosh, sidomos për luftën kundër lëndëve narkotike. Unë shikoj që atje punonjësit e policisë përpiqen jashtëzakonisht shumë, por me kushtet që kanë, me një mjet të vetëm, e kanë të pamundur të punojnë. Pra, është e domosdoshme që ai stacion policie të bëhet komisariat. Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sinaj!

Julian Hodaj - Çështja e klasifikimit stacion apo komisariat, është gjithsesi çështje organizim i brendshëm i policisë dhe në bazë të karakteristikave të zonave, problemeve që kanë

dhe impenjimeve që duhen, për terma numrash dhe funksionesh janë ata që duhet të vendosin llojin e impenjimit policor në terren. Gjithsesi, kjo nuk ka ndonjë efekt për buxhetin siç kanë dy çështjet e tjera që ngriti deputeti.

Për sa u përket mjeteve, pa dashur të përsërisim, është një vlerë e konsiderueshme e parashikuar në bashkëfinancim me Bashkimin Europian për blerje mjetesesh për Policinë e Shtetit dhe besoj që do të shpërndahen në mënyrë uniforme në të gjithë terrenin, duke kompensuar edhe ato struktura që sot vuajnë këtë mungesë logjistike.

E njëjta gjë është edhe për godinën. Ne jemi koshientë që ka mungesa në infrastrukturë dhe logjistikë, por, nëse shohim ku ishim para pak vitesh dhe ku jemi sot, shohim që kemi ecur shumë përpara dhe buxhetet vitet e fundit kanë qenë të konsiderueshme për të investuar në këtë drejtim, gjithashtu do të investohet akoma në të ardhmen. Unë besoj që me buxhetin që kemi në dispozicion, i cili është më i larti i viteve të fundit, disa nga këto probleme do të zgjidhen.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Hodaj!

Fjalën e ka zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, kryetare!

Personalisht e vlerësoj maksimalisht parashikimin e këtij buxheti, i cili përkon me objektivat e kësaj qeverie për sigurinë publike.

Unë kisha dy pyetje, ju thatë që është parashikuar një rritje me 16% e buxhetit të prefekturave. Në çfarë zërash ka rritje ky buxhet?

Është parashikuar restaurimi i prefekturës Tiranë dhe më vjen mirë, sepse është një institucion që e njoh personalisht, sigurisht që, përveç dinjitetit që i kthehet këtij institucioni, por edhe Tiranës i rikthehet një trashëgimi kulturore. Sa është vlera që është parashikuar në projektbuxhet për këtë restaurim?

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Palnikaj.

Dritan Palnikaj – Të nderuar deputetë, është parashikuar një rritje te zëri i prefekturave dhe rritja më e madhe shkon për prefekturën e Tiranës, për të cilën është parashikuar një fond prej 30 milionë lekësh. Ky nuk është financim i plotë, sepse projekti parashikohet të shtrihet në dy vjet dhe këtë vit do të bëhet procesi i tenderimit dhe lidhjes së kontratës dhe kjo varet se sa kohë marrin. Gjithashtu, është parashikuar një zë i veçantë për secilën prefekturë, e cila nuk është një shumë e

madhe për shkak të pamundësive buxhetore, por është parashikuar që në mënyrë të barabartë të gjithë prefektët të kenë nga një zë investimi si për mobilim ose nevoja imediate.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këto janë shpenzime operative, por jo koherente, pra janë shpenzime në investim. Pra, është një shumë simbolike që prefektët të kenë mundësi ta përmirësojnë infrastrukturën brenda prefekturës. Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Harusha.

Luan Harusha – Faleminderit, zonja kryetare!

Kisha një pyetje, gjatë verifikimit që ka bërë Komisioni i Sigurisë Kombëtare në disa pika kufitare të Republikës së Shqipërisë është konstatuar që ka mangësi në mjetet lundruese, në identifikimin dhe skanimin e pasaportave dhe në disa kamera të sigurisë së veçantë. A është menduar të ky buxhet për plotësimin e këtyre mangësive?

Dritan Palnikaj – Në vijim të pyetjes së deputetit, në buxhet është parashikuar të ketë një zë të veçantë për pjesën e pajisjeve që skanojnë pasaportat, ndërsa në lidhje me pajisjet lundruese dhe pajisjet e tjera që mund t'i shërbejnë kufirit, ne jemi në bashkëpunim dhe kërkojmë asistencën e marrëveshjes së zhvilluar me Frontex. Natyrisht, nuk mund të pretendohet për një rinovim flote për shkak të vlerës së lartë që ka, por investime dhe mundësi për ripërmirësimin e situatës janë të parashikuara në buxhetin e vitit 2019.

Ermonela Felaj – Po, zoti Harusha.

Luan Harusha – Nuk po them për rinovim, por po them për mangësi të disa kamerave specifike në zona ujore, por edhe në kufirin jeshil, si dhe mungesa të kompjuterave që skanojnë pasaportat. Pra, këto mangësi a janë marrë parasysh në këtë buxhet? Për shembull, në Qafë – Thanë kishte vetëm një kamera termike në 73 kilometër dhe e bënte të pamundur kontrollin e zonës në atë pikë kufitare.

Ermonela Felaj – Përpara se të përgjigjeni, për dijeninë tuaj, si përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, mbas çdo vizite që ne kemi bërë në çdo institucion të sigurisë, përfshirë këtu edhe pikat e kalimit kufitar, ne kemi operuar me një raport, të cilin ua kemi përcjellë institucioneve përkatëse përgjegjëse edhe për të nxitur çdo institucion që të fillojë dhe t'i prioritetizojë këto nevoja, dhe kolegu është duke pyetur për këtë pjesë. Unë nuk besoj që ju e keni mbyllur detajimin në zëra të buxhetit, sepse është normale që buxheti duhet të miratohet dhe pastaj të detajohet nga ana juaj,

por i gjithë qëllimi është që të tërheqim vëmendjen që në ato pika që ne si parlamentarë i kemi parë që janë të dobëta të kërkojmë ndërhyrje.

Do të kemi edhe raste të tjera për disa probleme që janë të përbashkëta me Ministrinë e Brendshme dhe me Ministrinë e Mbrojtjes që të zhvillojmë një seancë të veçantë. Ndërkohë që ne javës tjetër kemi parashikuar që të dyja institucionet në varësisë së Ministrisë së Brendshme, Drejtorinë e Kufirit dhe të Emigracionit dhe Gardën ta kemi së bashku me ju, por edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, me qëllim që t'u japim një fokus. Ju e dini që edhe vitin e kaluar ne e kemi bërë këtë gjë, ku kemi pasur SHQBA-në dhe institucione të tjera varësie që kemi dashur t'i dëgjojmë si të interesuar në këtë proces, me qëllim që edhe ne si parlamentarë të bëjmë detyrën që kemi, t'ju nxisim që të akomodoni sa më mirë kushtet dhe nevojat e punës në këto institucione. Duke dashur që ta vazhdojmë më tej diskutimin dhe duke dashur t'i japim përgjigje pyetjes që ringriti zoti Harusha, do t'ia jap fjalën edhe koleges Spahiu dhe pastaj marrim përgjigje për të dyja pyetjet.

Klodiana Spahiu – Përshëndetje!

Kisha një pyetje të shkurtër, sa përqind e investimeve të vitit 2018 janë realizuar, pra investimet e parashikuara?

Pyetja tjetër, nisur përsëri nga vizitat, në një vizitë që kemi bërë në kufirin e Durrësit, në prezantimin që bëri drejtoresha, ishte e dukshme që kishte mangësi në kapacitete. Puna për kontrollin e çdo mjeti që kalonte, krahasuar me numrin e punonjësve që kishin ishte me të vërtetë një ngarkesë shumë e madhe. Si e mendoni ju në këto rishqyrtime që do të bëni, a e vlerësoni të arsyeshme shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në kufirin detar?

Shikoj që 47% e buxhetit të investimeve i akordohet luftës kundër krimit të organizuar, kultivimit e trafikimit të lëndëve narkotike dhe mendoj që kufiri detar është një nga variantet më të shpeshta që përdoret për trafikimin e lëndëve, prandaj shtimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore do të ishte një domosdoshmëri edhe për të rritur efikasitetin e punës. Faleminderit!

Dritan Palnikaj – Në lidhje me problematikat e ngritura edhe nga deputeti Harusha, edhe nga deputetja Spahiu, për sa i përket pjesës së kufirit, sigurisht që gjatë hartimit të këtij buxheti janë marrë parasysh edhe raportimet dhe takimet e herëpashershme që kemi pasur edhe me Komisionin e Sigurisë. Kjo reflektohet edhe në faktin që një pjesë e 47%-shit të projektuar si buxhet në funksion të luftës së krimit të organizuar, shkon për kufirin. Siç e tha edhe relatori Ndreu, një nga rrugët kryesore është kufiri dhe kjo nuk diskutohet. Aty ku është e mundur në lidhje me

skanimin e pasaportave janë të parashikuara, ndërsa për sa u përket numrave dhe shtesave, kjo gjë zgjidhet brenda për brenda strukturës me planifikimet që bën edhe drejtoresha e kufirit dhe drejtori i përgjithshëm. Pra, numrat janë në varësi të alokimit të tyre. Këtë e mbajta shënim për t'ia reflektuar drejtorit të përgjithshëm dhe drejtoreshës së kufirit në mënyrë që kjo problematikë që keni konstatuar në terren të pasqyrohet në mënyrë që të zbatohet.

Për sa i përket realizimit të buxhetit të vitit 2018, dua të theksoj se e kam ndjekur të gjithë procedurën gjatë periudhës që kam ushtruar detyrën si sekretar i përgjithshëm dhe e them me garanci të plotë që buxheti është realizuar 100% në termat e kontraktimit, lidhjes së kontratave dhe përmbushjes së tij. Ajo çfarë i referoheni duke parë edhe shifrat e financës ka të bëjë me realizimin në thesar. Siç dihet në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor është koha kur livrohet malli, kur merren faturat dhe bëhen pranimet. Unë besoj se ky buxhet, siç është realizuar në formë kontratash e kontraktimesh, do të realizohet dhe do të livrohet brenda datës 20 dhjetor në thesar, por edhe me fatura pranë Ministrisë së Financave. Ajo që është e rëndësishme është që deri në datën 15 tetor ne nuk kemi pasur asnjë fond të pakontraktuar dhe kjo është absolute.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Nëse nuk ka pyetje nga kolegët, më lejoni të bëj edhe unë disa pyetje. Nuk e dëgjuam gjatë fjalës tuaj, por më duhet t'ju pyes a është i mjaftueshëm buxheti që është parashikuar t'i jepet Ministrisë së Brendshme për vitin 2019, në gjykimin tuaj?

Me këtë rast të sqarojmë edhe publikun, u tha këtu që ka një ulje të lehtë që vjen për shkak të rialokimit, kalimit të disa fondeve tek AKSHI që ishin parashikuar për gjendjen civile, a mund të na e sqaroni këtë moment për të mos krijuar historira të tjera që nuk i përgjigjen një të vërtete, sepse buxheti me një llogari shumë të thjeshtë nga të gjithë është po ai që ka qenë edhe për vitin 2018, i cili ka qenë një buxhet i lartë.

Pyetja e dytë, a mund të na tregoni se sa parashikohet të jetë vlera e financimit të huaj për Ministrinë e Brendshme për vitin që vjen? Çfarë prokurimesh synon të kryejë institucioni i Ministrisë së Brendshme për vitin 2019? Meqenëse këtu u fol shumë për kapacitete njerëzore, që ende nuk janë plotësuar në çdo nivel, a mund të na thoni se çfarë prurjesh pritet të kemi nga Akademia e Sigurisë dhe si planifikohet të bëhet shpërndarja e këtyre trupave?

Julian Hodaj – Faleminderit!

Në terma të përgjithshëm ne thamë se buxheti është me rritje me 1% nga viti i kaluar dhe në gjykimin tonë buxheti është i mjaftueshëm që institucioni në tërësinë e tij, pra në 5 programet buxhetore të funksionojë normalisht.

Kalimi i mirëmbajtjes së gjendjes civile tek AKSHI, iu referova asaj që mund të duket një ulje në një program specifik, në krahasim me vitin 2018, por, pavarësisht kësaj, buxheti i Ministrisë së Brendshme është përsëri me rritje. Kjo do të thotë që edhe ajo shumë që shpenzohej nga Ministria e Brendshme vitin e kaluar për mirëmbajtjen e sistemit të gjendjes civile që sot do të përballohet nga një institucion tjetër, është përsëri në dispozicion të Ministrisë së Brendshme për investime dhe shpenzime të tjera.

Për sa i përket vlerës së financimit të huaj, ne besojmë se do të jetë rreth 8 milionë dollarë për vitin 2019. Këto janë fonde të aprovuara dhe të miratuara. Në këtë llogari nuk kemi futur programet e reja të Bashkimit Europian që do të fillojnë në vitin 2019 dhe që kanë një komponent të rëndësishëm për Ministrinë e Brendshme kur vjen fjala për ruajtjen e kufirit. Gjithashtu, në zbatim të marrëveshjes Frontex, parashikohet të vijë edhe një investim tjetër në lidhje me akdeminë e sigurisë në mbështetje ndaj luftës së krimit të organizuar dhe kështu me radhë. Këto ardhje që me shumë gjasa do të bëhen operative nga 1 janari ose nga 1 shkurti i vitit tjetër, ne nuk i kemi llogaritur. Sot për sot e saktë është që 8 milionë dollarë janë financime të huaja për Ministrinë e Brendshme.

Për sa u përket burimeve njerëzore të strukturave të ndryshme, ju duhet ta dini që sapo përfundoi testimi për patrullat e përgjithshme, që është hyrja e re që u bë këtë vit dhe besoj që e njëjta shifër, diku te 180 veta, mund të jenë edhe rekrutimet e reja për vitin tjetër, kjo gjithmonë e bazuar në numrin e atyre që dalin në pension, që dorëhiqen apo nga vakancat që krijohen.

Për sa u përket prokurimeve, dua që ta shpjegonte sekretari i përgjithshëm. Faleminderit!

Dritan Palnikaj – E nderuara kryetare, investimet që vlejné më shumë dhe që janë parashikuar për vitin e ardhshëm kanë një specifikë të veçantë, kryesisht është ndërtimi i objektit trekatësh që do të shërbejë për DPV-në Tiranë, siç e parashitoi edhe zëvendësministri, do të planifikojmë ndërtimin e një objekti të veçantë për të paraburgosurit që të mos jenë më në disa komisarate, por të mblidhen të gjithë në një objekt të veçantë. Kjo besoj se zë edhe zërin më të madh. Gjithashtu, parashikojmë blerjen e armatimit dhe blerjen e mjeteve me karakter special që mund t'i shërbejë policisë kriminale. Në prokurim do të jetë ndërtimi i Prefekturës së Tiranës që parashikohet të fillohet në janar, i cili është një studim dyvjeçar. Gjithashtu, janë edhe disa studime

dhe projekte, ku duhet të evidentojmë që disa pjesë nga buxheti i financimeve janë tashmë të prokuruar, siç është DPV Shkodër, apo reparti RENE, që tashmë është në përfundim dhe mendoj që në vitin 2019 do të kemi edhe inaugurimin e këtij objekti. Një pjesë e këtyre fondeve do të jenë si detyrim i mbartur nga viti 2018, kurse zhvillimi i programeve të reja do të jetë në vitin 2019.

Ermonela Felaj – Faleminderit për shpjegimet tuaja!

A ka diskutime nga kolegët? Nuk ka.

Besoj që këtë herë jeni mirëkuptuar 100% me Ministrinë e Financave dhe buxheti është i mjaftueshëm që Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit mund të kryejnë detyrat e tyre, ashtu siç e përshkruan ligji.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”

Kush është dakord në parim me këtë projektligj, për sa u takon parashikimeve në Ministrinë e Brendshme? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme për prezencën.

Këtu mbyllet mbledhja.

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA